Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

# RAPORT VJETOR 2021

I AUTORITETIT KOMBËTAR TË KUALIFIKIMEVE



www.akk-ks.net

# Përmbajtja

Fjalë hyrëse....4
Misioni....6
Vizioni....7
Autoriteti Kombëtar I Kualifikimeve....7
Përbërja e Këshillit drejtues të AKK-së....9
Korniza ligjore....11
Synimet dhe objektivat....11
Akterët e rëndësishëm....12
Planifikimi dhe plani i punës 2021....13
Raporti i aktiviteteve për vitin 2021....14
Implementimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK)....14
Verifikimi i standardeve të profesionit....14
Validimi dhe aprovimi i kualifikimeve në KKK dhe akreditimi i ofruesve të AAP....18
Njohja e Mësimit Paraprak (NjMP)....28
Monitorimi i institucioneve pas akreditimit....29
Promovimi I KKK....34
Takimet me palët e interesit....34
Organizimi i punëtorive dhe seminareve....35
Botimi dhe shpërndarja e publikimeve dhe materialeve promovuese....36
Mirëmbajtja dhe përditësimi I uebfaqes....37
Bashkëpunimi ndërkombëtar....37



## Fjalë hyrëse

Raporti i punës për vitin 2021, prezenton punën dhe aktivitetet e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK) gjatë periudhës njëvjeçare. Përkundër sfidave dhe ballafaqimit me pandeminë "Covid 19", Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve ka vazhduar drejt realizimit të misionit për të mbështetur të gjithë ofruesit drejt rritjes së cilësisë në Arsimin dhe Aftësimin Profesional (AAP), me qëllim që nxënësit/kandidatët të pajisen me shkathtësitë e duhura për tregun e punës.

Ky raport është dëshmi e udhëheqjes kreative, angazhimit dhe përkushtimit të stafit të AKK. Lista e aktiviteteve të organizuara gjatë 2021 është mbresëlënëse, sidomos kur merren parasysh situata me pandeminë dhe burimet e kufizuara njerëzore që AKK posedon. Efekti sinergjik brenda këtij ekipi të vogël, por entuziast, ka dhënë rezultate të rëndësishme, të cilat janë të evidentuara nga reputacioni dhe kredibiliteti i AKK brenda dhe jashtë vendit.

Arsimi dhe Aftësimi Profesional në politikat dhe programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës është prioritet.Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, në përputhje me programin e Qeverisë, është përkushtuar dhe ka kontribuar në këtë fushë, duke verifikuar dhe aprovuar një numër të konsideruar të standardeve kombëtare të profesionit, duke validuar dhe rivalidiuar 51 kualifikime në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), dhe ka akredituar dhe riakredituar 20 institucione që ofrojnë arsim dhe aftësim profesional në Kosovë.

E veçantë për këtë vit ishte akreditimi i institucioneve për zbatimin e Njohjes së Mësimit Paraprak, politikë e zhvilluar nga AKK me qëllim të ofrimit të një sistemi të fuqishëm profesional për të gjithë, në rritjen e punësimit të të rriturve dhe në rritjen e shkathtësive të fuqisë punëtore të certifikuar.

AKK edhe këtë vit, ka vazhduar bashkëpunimin me akterë të rëndësishëm ndërkombëtar, duke përfituar e shkëmbyer përvoja të ndryshme dhe ekspertizë profesionale.

Duke qenë se, orientimi ynë strategjik shtetëror është integrimi në tregun evropian, koordinimi dhe bashkërendimi me këto institucione dhe rrjete evropiane ka rëndësi të veçantë.

Për këto arritje, ne i jemi shumë mirënjohës Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Fondacionit Evropian për Trajnim dhe partnerëve tjerë zhvillimorë dhe donatorëve për angazhimin dhe zotimin e vazhdueshëm për të përkrahë AKK drejt përmbushjes së misionit, që të rrisë cilësinë në arsimin dhe aftësimin profesional në Kosovë.

Një falënderim i veçantë vlen edhe për ministren e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, znj. Arbërie Nagavci, për mbështetjen dhe zotimin për përkrahje të mëtejme të AKK dhe KKK-së. Gjithashtu, falënderoj Këshillin drejtues dhe stafin e AKK për kontributin madhor në zhvillimin e institucionit, si dhe performancën gjatë vitit 2021.

## Misioni

Misioni i AKK-së, është të mbikëqyrë dhe të zhvillojë Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve në kontekst të të mësuarit gjatë gjithë jetës, në partneritet me nxënësin/kandidatin, punëdhënësin dhe ofruesit e arsimit dhe aftësimit në të gjitha nivelet dhe në përputhje me nevojat dhe kërkesat e shoqërisë dhe ekonomisë.



## Vizioni

Vizioni i AKK është krijimi i një sistemi cilësor, të besueshëm dhe transparent të kualifikimeve kombëtare, me qëllim të rritjes së mundësive për zhvillim, punësim, progres dhe mobilitet për të certifikuarit në kualifikimet e KKK.




**Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve**

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), është organ i pavarur publik, i themeluar sipas Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikime Kombëtare.

Sipas Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikime Kombëtare, AKK është përgjegjëse për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) si dhe rregullon dhënien e kualifikimeve brenda kornizës.
Funksionimi i Autoritetit mbështetet në legjislacionin në fuqi, rregullore, udhëzimet administrative, Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), dokumente politikash dhe udhëzues të ndryshëm. Sipas ligjit të lartcekur AKK, ka Këshillin Drejtues prej trembëdhjetë (13) anëtarësh, të aprovuar nga Qeveria e Kosovës, të cilët përfaqësojnë ministritë dhe partnerët social si dhe universitetet. Këshilli drejtues i AKK, takohet së paku gjashtë (6) herë në vit.

Për realizimin e funksioneve dhe obligimeve, punëve dhe detyrave në AKK janë të punësuar gjithsej dhjetë zyrtarë.

AKK ka përgjegjësi përcaktimin e niveleve të kualifikimeve në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve, ndërlidhjen dhe harmonizimin me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve(KEK), verifikimin dhe aprovimin e standardeve të profesionit, përcaktimin e kritereve për aprovimin e kualifikimeve dhe akreditimin e institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional (AAP), përfshirjen e kualifikimeve të aprovuara në KKK, lehtësimin e progresit dhe transferit, njohjen e mësimit paraprak (NjMP), sigurimin e jashtëm të cilësisë, si dhe monitorimin e institucioneve të akredituara të AAP.

Sistemi i arsimit dhe aftësimit profesional (AAP), si dhe ai i arsimit të lartë (AL) në Kosovë, duhet t'i plotësojë në mënyrë të përshtatshme nevojat e ekonomisë së tregut.

Ngritja e cilësisë në sistemin e arsimit dhe aftësimit profesional dhe arsimit të lartë, është prioritet i Qeverisë së Kosovës dhe shoqërisë sonë, në mënyrë që shkathtësitë profesionale dhe kompetencat e individëve që përfundojnë AAP dhe AL, të jenë në nivel të kënaqshëm. Përkundër progresit të arritur deri më tani, mbetet ende sfidë për të gjithë akterët relevant në Republikën e Kosovës që të krijojnë fuqi punëtore të aftë, fleksibile dhe konkurrent në tregun vendor, rajonal e më gjerë.

Prandaj, një ndër kriteret kryesore që duhet të plotësojnë kualifikimet për tu aprovuar dhe vendosur në KKK është përputhja e këtyre kualifikimeve me kërkesat e tregut të punës. Ky është ndikimi i drejtpërdrejt i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve në ekonominë tonë. Korniza me kriteret e saj parasheh që institucionet, të cilat dëshirojnë të zhvillojnë një kualifi- kim, duhet të paraqesin dëshmi se kualifikimi kërkohet në tregun e punës. Si dëshmi mund të përdoren hulumtimet e tregut të punës, konsultimet, rekomandimet e institucioneve qeveritare që zhvillojnë politika zhvillimore si MASHT, MPMS, OEK, KAAPRr, etj. Gjithashtu, sipas KKK, kualifikimet e zhvilluara duhet të bazohen në standarde të profesionit, të cilat janë bazë për ta arritur këtë.

Standardet e profesionit duhet të zhvillohen drejtpërdrejt bazuar në kërkesat e profesionit të caktuar në vendin e punës. Punëdhënësi merr pjesë aktive në këtë proces dhe paraqet kërkesat e nevojshme, të cilat punëtori duhet t'i demonstrojë për kualifikimin në fjalë. Kjo është një ndër kriteret e KKK që duhet të plotësohet nga institucionet, të cilat zhvillojnë kualifikime. AKK ka zhvilluar dhe hartuar udhëzues të shumtë, të cilët ndihmojnë institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional t'i përmbushin kriteret që kualifikimet e tyre të jenë pjesë e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.

## Përbërja e Këshillit drejtues të AKK-së:

| | |
|---|---|
| Agron Bajraktari | Kryetar, Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (USHA - Ferizaj) |
| Arian Zeka[1] | Nënkryetar, Oda Ekonomike Amerikane (OEA) |
| Faruk Ahmeti | Anëtar, Ministria e Financave (MF) |
| Hysen Balaj[2] | Anëtar, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) |
| Anita Malaj[3] | Anëtare, Ministria e Shëndetësisë (Msh) |
| Enver Hajrullahu | Anëtar, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) |
| Kadrije Meniqi[4] | Anëtare, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) |
| Hysen Bytyqi | Anëtar, Universiteti i Prishtinës (UP) |
| Bekim Hasanaj | Anëtar, Don Bosko |
| Vjollca Gërvalla | Anëtare, Agjencioni i përkrahjes së punësimit Kosovë (APPK) |
| Mehreme Llumnica | Anëtare, (HENDIKOS) |
| Fisnik Lakna | Anëtar, Agjencia e Akreditimit të Kosovës (MPMS) |
| Besim Mustafa | Anëtar, Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) |
| Fatlinda Gashi[5] | Anëtare, Ministria e Financave (MF) |
| Majlinda Rizvanolli Bajraktari[6] | Anëtare, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASHTI) |
| Bekim Fusha[7] | Anëtar, Ministria e Shëndetësisë (Msh) |
| Ryve Prekorogja[8] | Anëtare, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASHTI) |

[1] Deri me datë 11 nëntor 2021 ka qenë anëtar i KD së AKK
[2] Deri me datë 11 nëntor 2021 ka qenë anëtar i KD së AKK
[3] Deri me datë 11 nëntor 2021 ka qenë anëtar i KD së AKK
[4] Deri me datë 11 nëntor 2021 ka qenë anëtar i KD së AKK
[5] Nga data 11 nëntor 2021 është emëruar anëtar i KD së AKK
[6] Nga data 11 nëntor 2021 është emëruar anëtar i KD së AKK
[7] Nga data 11 nëntor 2021 është emëruar anëtar i KD së AKK
[8] Nga data 11 nëntor 2021 është emëruar anëtar i KD së AKK



*Takimi i Këshillit Drejtues të AKK*

## Stafi i AKK:

| | |
|---|---|
| Avni Gashi | U.D. i drejtorit të AKK |
| Bleta Kadriu | Eksperte për standarde |
| Milot Hasangjekaj | Ekspert për kualifikime |
| Kaltrina Mulliqi | Eksperte për sigurim të cilësisë |
| Anitë Rukovci | Zyrtare e lartë për monitorim të institucioneve |
| Donjeta Nimani | Zyrtare e lartë për njohjen e mësimit paraprak |
| Pakize Isufaj | Zyrtare e lartë për financa |
| Hysni Mustafa | Zyrtar i lartë ligjor |
| Vilzan Arifaj | Zyrtar i lartë për Teknologji informative dhe Logjistikë |
| Donjeta Gashi | Asistente administrative |

## Korniza ligjore

**Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, kryen funksionet dhe përgjegjësitë në pajtim me:**

• Ligjin nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare;
• Ligji nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional;
• Ligji nr. 04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur në Republikën e Kosovës;
• Rregullorja nr.01/196 për Punën e Këshillit drejtues të Autoritetit Kombëtar te Kualifikimeve;
• Rregullorja nr.01/521 për Përcaktimin e Procedurave për Aplikimin e Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP) për Akreditim Institucional, Validim dhe Aprovim të Kualifikimeve sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), dhe për Aplikim të Institucioneve që Zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak (NjMP);
• Udhëzimi administrativ (MASHT) nr.09/2019 për Kriteret dhe Procedurat për Akreditimin e Institucioneve që e Zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak në Kosovë;
• Udhëzimi administrativ (MASHT) nr.35/2014 për Kriteret dhe Procedurat për Validimin dhe Aprovimin e Kualifikimeve Kombëtare dhe Akreditimin e Institucioneve qe Ofrojnë Kualifikime në Kosovë;
• Udhëzimi administrativ (MASHT) nr.32/2014 për Kriteret dhe Procedurat për Sigurimin e Cilësisë në Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional – Proceset e Brendshme;
• Udhëzimi administrativ (MASHT) nr.31/2014 për Njohjen e Mësimit Paraprak;
• Udhëzimi administrativ (MASHT) nr.28/2014, për Kriteret dhe Procedurat për Verifikimin e Standardit të Profesionit.

**Synimet dhe objektivat**

Ndër synimet parësore të AKK është implementimi dhe përditësimi i sistemit Kombëtar të Kualifikimeve (KKK) në kontekst të të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe në partneritet me kandidatë, punëdhënës dhe institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional (IAAP) në përputhshmëri me nevojat dhe kërkesat e shoqërisë dhe ekonomisë.

**Për ta arritur këtë, AKK:**

• përcakton kriteret dhe aprovon kualifikimet që përfshihen në nivelet e caktuara të KKK;
• përcakton kriteret dhe akrediton, rregullon dhe monitoron institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional (IAAP);
• mirëmban bazën e të dhënave të kualifikimeve në KKK dhe certifikatave e diplomave të dhëna;
• bën rishikime periodike të vlerësimit, si dhe krahasime ndërkombëtare të kualifikimeve;

• bën këshillimin e institucioneve përgjegjëse për njohjen e kualifikimeve të huaja, për qëllime akademike/profesionale ose punësimi, përkitazi me çështjet e krahasueshmërisë dhe barasvlerës;
• miraton dhe vulos certifikatat, diplomat për kualifikimet në KKK duke përfshirë titullin e aprovuar të kualifikimit, nivelin e tij në KKK, kreditë, si dhe informata tjera.




**Akterët e rëndësishëm**

Për të ushtruar funksionet dhe përgjegjësitë e veta, AKK krijon, zhvillon dhe mirëmban raporte bashkëpunimi dhe konsultimi me të gjithë akterët relevant të KKK, përfshirë:

• Nxënësit/kandidatët/studentët;
• Mësimdhënësit, trajnerët dhe instruktorët;
• Institucionet publike dhe private të arsimit dhe aftësimit profesional, kolegje dhe universitete;
• Koordinatorët për sigurimin e cilësisë;
• Punëdhënësit dhe të punësuarit;
• Sindikata dhe shoqata profesionale;
• Agjencitë relevante dhe Këshillat profesionale;
• Qeverinë qendrore dhe lokale, etj.

## Planifikimi dhe plani i punës 2021

AKK zhvillon politika dhe strategji për krijimin dhe zbatimin e Sistemit Kombëtar të Kualifikimeve në pajtueshmëri me Ligjin për Kualifikimet Kombëtare.

Bazuar në objektivat strategjike, AKK harton planin e punës, duke i përcaktuar prioritetet dhe aktivitetet vjetore. KD i AKK miraton planin vjetor të punës së AKK, ndërsa stafi ekzekutiv është përgjegjës për zbatimin e detyrave dhe aktiviteteve të përcaktuara.

AKK paraqet raportin vjetor për miratim në Këshillin Drejtues, e pas miratimit në Qeverinë e Kosovës çdo fund vit. Raporti vjetor publikohet në uebfaqe të AKK.

KD i AKK-së në fillim të vitit ka miratuar planin e punës për vitin 2021, synimet e të cilit ishin:

1. Promovimi dhe zbatimi i KKK në linjë me kërkesat dhe nevojat e sistemit të kualifikimeve në vend dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (KEK);
2. Verifikimi dhe miratimi i standardeve të profesionit (SP);
3. Validimi dhe rivalidimi i kualifikimeve profesionale në KKK dhe akreditimi dhe riakreditimi i institucioneve publike dhe private të arsimit dhe aftësimit profesional (AAP);
4. Monitorimi i institucioneve të akredituara, hartimi i aktit nënligjor për monitorim;
5. Dizajnimi i platformës elektronike të monitorimit të institucioneve pas akreditimit;
6. Akreditimi i institucioneve për Njohjen e Mësimit Paraprak (NjMP);
7. Bashkëpunimi profesional me institucionet e AAP për sigurimin e cilësisë;
8. Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet partnere për zbatimin e KKK;
9. Promovimi i KKK përmes aktiviteteve me qëllim të informimit të opinionit dhe grupeve të interesit lidhur me strukturën, llojet e kualifikimeve, progresin dhe mundësitë tjera;
10. Bashkëpunimi dhe zgjerimi i partneriteteve me institucione vendore e ndërkombëtare duke përfshirë edhe projektet e BE-së dhe organizmave tjerë të rëndësishëm;
11. Zhvillimi profesional dhe rritja e kapaciteteve të AKK-së përmes trajnimeve profesionale;
12. Rekrutimi i stafit profesional dhe mbështetës;
13. Procedimi i Rregullores për Sistematizimin e Vendeve të Punës të AKK;
14. Hartimi i Ligjit të AKK;
15. Rishikimi i akteve nënligjore.

Plani i punës për vitin 2021, është publikuar në uebfaqen e AKK: https://akkks.rks- gov.net/akk/raporti-vjetor-i-akk-se

## Raporti i aktiviteteve për vitin 2021

Ky raport është një përmbledhje e aktiviteteve dhe objektivave të realizuara të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve gjatë vitit 2021 në përputhje me planin e punës për këtë vit dhe në përputhje me Ligjin për Kualifikimet Kombëtare. Raporti është hartuar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve dhe miratuar nga Këshilli drejtues i AKK-së.

Raporti i punës është i strukturuar sipas funksioneve të AKK dhe prezenton punët e bëra, rezultatet e arritura dhe sfidat që e kanë përcjellë gjatë periudhës raportuese.

**Implementimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK)**

KKK është e rregulluar përmes mekanizmave të cilët sistemin e kualifikimeve kombëtare e bëjnë cilësor, të përshtatshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.
Mekanizmat për arritjen e këtyre objektivave janë:

- Verifikimi i standardeve të profesionit;
- Validimi dhe aprovimi i kualifikimeve të propozuara për përfshirje në KKK;
- Akreditimi i institucioneve përgjegjëse për ofrimin, vlerësimin dhe certifikimin e kualifikimeve të miratuara të KKK-së;
- Njohja e mësimit paraprak (NjMP);
- Monitorimi i institucioneve pas akreditimit;
- Promovimi I KKK.

**Verifikimi i standardeve të profesionit**

Standardet e profesionit janë njësi për ta matur shkallën deri në të cilën një individ mund ti përmbushë kërkesat për realizim në një profesion të veçantë ose grup profesionesh, me qëllim që të hyjë ose përparojë në kuadër të një profesioni ose fushe përkatëse profesionale. Standardi i profesionit është pikënisje për zhvillimin e kualifikimit, kurrikulës, programit, kritereve të vlerësimit, rezultateve mësimore, etj.

Standardi i profesionit zhvillohet në bashkëpunim: MASHTI, MPMS, ministritë tjera relevante, partnerët socialë dhe shoqatat e zejtarëve. Standardi i profesionit zhvillohet duke u bazuar në metodat për zhvillimin e tyre si dhe bazuar në kriteret e përcaktuara nga AKK. Standardi i profesionit verifikohet nga AKK. Standardi i profesionit i cili kalon në procesin e verifikimit dhe miratohet nga KAAPRr quhet standard kombëtar I profesionit.



*Takim gjatë procesit të verifikimit të standardit të profesionit.*

Në zbatim të planit të punës, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) gjatë vitit 2021, ka zhvilluar gjithsej 27 procese të verifikimit të standardeve të profesionit, gjë që ka rezultuar me rritjen e numrit të standardeve në nivel vendi. Nga këto 27 procese të verifikimit të standardeve të profesionit, 10 prej tyre janë miratuar si standarde kombëtare të profesionit, kurse 17 nga to janë në proces të përmirësimit nga ana e zhvilluesve të tyre me qëllim të miratimit të tyre nga Këshilli drejtues i AKK.

Për realizimin e këtyre proceseve janë rekrutuar një numër i konsideruar i stafit profesional (ekspertë të jashtëm) sipas procedurave ligjore.Standardet e profesionit janë zhvilluar nga institucione dhe partnerë të ndryshëm si MASHTI (mbështetur nga projekti EYE dhe ALLED), AAPRr (mbështetur nga DVV Internacional), Oda Ekonomike e Kosovës dhe shoqata të bizneseve.

| Nr. | Standardet e profesionit te aprovuar nga KD e AKK | Zhvilluesi i standardit të profesionit |
|---|---|---|
| 1 | Udhëheqës/e i/e hotelit | Projekti TO REGOS |
| 2 | Këpucëtarët dhe punëtorët e ngjashëm | Partnerët social/Fabrika "Solid" |
| 3 | Punëtorët e zejes me tekstil, lëkurë dhe materiale të ngjashme | MASHT/EYE |
| 4 | Zyrtar policor | AKSP dhe Policia e Kosovës |
| 5 | Inspektor i Inspektoratit Policor të Kosovës | AKSP dhe Inspektorati Policor i Kosovës |
| 6 | Zyrtar korrektues | AKSP Shërbimi Korrektues i Kosovës |
| 7 | Zyrtar Sprovues | AKSP dhe Shërbimi Sprovues i Kosovës |
| 8 | Zyrtar Doganor | AKSP dhe Dogana e Kosovës |
| 9 | Zjarrfikës | AKSP dhe Agjencia e Menaxhimit te Emergjencave |
| 10 | Mekanikët dhe riparuesit e automjeteve | AAAPARr/DVV International |

*Tabela 1. Standardet e profesionit të verifikuara dhe të aprovuara nga KD i AKK gjatë vitit 2021*

Në tabelën më poshtë janë të dhënat e standardeve të profesionit të cilat kanë kaluar nëpërmes procesit të verifikimit, por që janë në pritje të miratimit nga Këshilli drejtues i AKK. Në këtë tabelë janë 17 standarde të profesionit që janë zhvilluar nga projekti EYE/MASHT, AAAPARr me mbështetje të DVV International dhe Shoqata e artistëve të Tatuazhit.


| Nr. | Emri i standardit të profesionit | Zhvilluesi i standardit të profesionit |
|---|---|---|
| 1 | Teknik i operimit me TIK | MASHT/EYE |
| 2 | Teknikët e inxhinierisë së telekomunikimit | MASHT/EYE |
| 3 | Punëtorët e zejes me tekstil, lëkurë dhe materiale të ngjashme | MASHT/EYE |
| 4 | Teknikët e bujqësisë | MASHT/EYE |
| 5 | Ndërtuesit e shtëpive | MASHT/EYE |
| 6 | Punëtorët e kornizave të ndërtimit | MASHT/EYE |
| 7 | Shtruesit e dyshemesë dhe punëtorët për vendosjen e pllakave | MASHT/EYE |
| 8 | Suvatuesit | MASHT/EYE |
| 9 | Ngjyrosësit dhe punëtorët e ngjashëm | MASHT/EYE |
| 10 | Mekanikët e kondicionerëve dhe të ftohjes | MASHT/EYE |
| 11 | Punëtorët e impiantit për gjenerimin e energjisë | MASHT/EYE |
| 12 | Prodhuesit e tapicerive dhe të ngjashme | MASHT/EYE |
| 13 | Dizajnerët dhe dekoderët e enterierit | MASHT/EYE |
| 14 | Nëpunës i prodhimit | MASHT/EYE |
| 15 | Microblading artist/artiste | Shoqata e Artistëve të Tatuazhit të Kosovës |
| 16 | Rrobaqepësit, rrobaqepëset, gëzofpunuesit dhe kapelabërësit | AAAPARr/DVV Internacional |
| 17 | Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit | AAAPARr/DVV Internacional |

*Tabela 2. Standardet e profesionit të verifikuara gjatë vitit 2021*

Në këtë tabelën janë të paraqitura SP të cilat janë miratuar nga Këshilli drejtues i AKK për të hyrë në fazën e verifikimit.

| Nr. | Emri i standardit të profesionit | Zhvilluesi i standardit të profesionit |
|---|---|---|
| 1 | Teknik i inxhinierisë elektronike | MASHT dhe ALLED 2 |
| 2 | Mekanikët dhe riparuesit e makinerisë bujqësore dhe industriale | MASHT dhe ALLED 2 |
| 3 | Teknik i pylltarisë | MASHT dhe ALLED 2 |
| 4 | Ngjyrosësit me spërkatje dhe lustruesit me llak | MASHT dhe ALLED 2 |
| 5 | Mekanikët dhe montuesit elektrik | MASHT dhe ALLED 2 |
| 6 | Kamerierët | MASHT dhe ALLED 2 |
| 7 | Mekanikët dhe punëtoret e servisimit të pajisjeve elektronike | MASHT dhe ALLED 2 |
| 8 | Prodhuesit e produkteve të bulmetit | MASHT dhe ALLED 2 |
| 9 | Punëtoret e llamarinave | MASHT dhe ALLED 2 |

*Tabela 3. Standardet e profesionit në proces të verifikimit.*




*Diagrami 1. Standardet e profesionit sipas sektorëve*

**Validimi dhe aprovimi i kualifikimeve në KKK dhe akreditimi i ofruesve të AAP**

Bazuar në planin e punës gjatë vitit 2021, AKK ka realizuar aktivitetet që kanë të bëjnë me validimin dhe aprovimin e kualifikimeve dhe akreditimin e ofruesve të AAP-së, vlerësimin dhe vizitat e ekspertëve në institucionet përkatëse, dokumentacionit, hapësirave dhe pajisjeve për punë, stafin e nevojshëm dhe aspektet tjera të rëndësishme.

Në procesin e vlerësimit, përveç stafit të AKK, sipas legjislacionit në fuqi AKK ka angazhuar ekspertë të jashtëm sipas sektorëve dhe fushave përkatëse. Në funksion të njësimit të procedurave dhe kredibilitetit të procesit, janë organizuar takime konsultative me të gjithë ekspertët e përfshirë. Takimet kishin qëllim informues, metodologjinë lidhur me procesin e validimit dhe akreditimit të institucioneve aplikuese dhe dinamikën e procesit e transparencën.

Në vitin 2021, nga stafi i AKK dhe ekspertët janë realizuar procedurat për standarde për institucionet aplikuese sipas rregullores në fuqi me nr. 01/2020 për përcaktimin e procedurave për aplikimin e institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional (IAAP) për akreditim institucional, validim dhe aprovim të kualifikimeve sipas KKK dhe për aplikim të institucioneve që zbatojnë NjMP:

- Konsultimi me përfaqësuesit e AAP
- Shqyrtimi dhe vlerësimi i dosjes së institucioneve aplikuese nga AKK përmes listës së kontrollit
- Aprovimi i dosjes aplikuese nga KD i AKK
- Përzgjedhja e ekipit të ekspertëve për vlerësim
- Shqyrtimi i dosjes së institucioneve aplikuese nga ekipi i ekspertëve
- Vizita në institucione
- Hartimi i raporteve të vlerësimit për validim të kualikimit dhe akreditim të institucionit
- Aprovimi i raporteve vlerësuese nga KD i AKK.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat për aplikacionet e shqyrtuara nga stafi i AKK dhe të aprovuara nga KD i AKK për vitin 2021.

| Nr. | Institucionet | Kualifikimet | Numri i kualifikimeve |
|---|---|---|---|
| 1 | Getting Competent | Trajner ne kompani | 2 |
| | | Instruktor/Mësimdhënës për të rritur | |
| 2 | Akademia e Kosovës për Siguri Publike | Zyrtar Policor | 6 |
| | | Inspektor i Inspektoratit policor | |
| | | Zjarrfikës | |
| | | Zyrtar korrektues | |
| | | Zyrtar sprovues | |
| | | Zyrtar doganor | |
| 3 | Camellias | Manikyr | 1 |
| 4 | Creative Education | Gjuhë angleze | 2 |
| | | Gjuhë gjermane | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 5 | ISPE | Teknik dentar | 4 |
| | | Asistent i kujdesit social shëndetësor | |
| | | Asistent i fizioterapisë | |
| | | Teknik i farmacisë. | |
| 6 | British School | Bashkëpunëtor profesional i infermierisë | 2 |
| | | Teknik dentar | |
| 7 | Gjon Nikollë Kazazi | Bashkëpunëtor profesional i infermierisë. | 1 |
| 8 | Illusion Academy | Manikyr | 3 |
| | | Grimer | |
| | | Parukeri | |
| 9 | Qendra e Kompetencës – Skenderaj | Murator | 1 |
| 10 | UBT | Asistent dentar | 4 |
| | | Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë | |
| | | Teknik i Farmacisë | |
| | | Teknik i Laboratorit Mjekësor | |
| 11 | Vicianamed | Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë | 1 |
| 12 | Coiffure School | Parukeri | 3 |
| | | Grim | |
| | | Manikyr | |
| 13 | Smart Center | Gjuhë angleze | 2 |
| | | Gjuhë gjermane | |
| 14 | ATC | Automekanik | 5 |
| | | Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimeve | |
| | | Gjuhë angleze | |
| | | Instalues elektrik | |
| | | Menaxher i ndërmarrjeve mikro dhe të vogla | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 15 | I2 Defense | Trajnerët, instruktorët dhe zyrtaret. | 1 |
| 16 | IBCM | Shitja dhe përkujdesje ndaj klientit | 4 |
| | | Menaxher i ndërmarrjeve mikro dhe të vogla | |
| | | Asistent administrativ | |
| | | IT help desk | |
| 17 | Kolegji evropian | Ekspert për siguri dhe shëndet në punë | 3 |
| | | Shitja dhe përkujdesja ndaj klientit | |
| | | Teknik i zhvillimit të softuerit | |
| 18 | Loyola | Mekatronikë | 1 |
| 19 | Tempulli | Instruktor i shoferëve | 1 |
| 20 | Universum | Nëpunës i kontabilitetit | 1 |
| 21 | QT KEK | Instalues elektrik | 1 |
| 22 | Elektroëati | Instalues elektrik | 1 |
| 23 | Diakonie Training Center | Instalues Elektrik | 3 |
| | | Instalues i Ngrohjes Qendrore | |
| | | Instalues i Ujësjellësit dhe Kanalizimit | |
| 24 | Meister Training Center | Instalues Elektrik; | 3 |
| | | Instalues i Ngrohjes, Klimatizimit, Ujit dhe Kanalizimit; | |
| | | Mekatronikë | |
| 25 | Qendra e Kompetencës - Prizren | Këshilltar për karrierë. | 1 |
| 26 | Uni BB Fashion Academy | Modelist, prerës dhe punues të tekstilit dhe të tjerë; | 2 |
| | | Rrobaqepës, prerës dhe punues te tekstilit dhe te tjerë te ngjashëm. | |
| 27 | BRITANNICA ELT SCHOOL | Gjuhe Angleze | 1 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 28 | EKOPACK | Bërës ëmbëlsirash | 1 |
| 29 | Termo Hidrauliku | Instalues i ujësjellësit, ngrohjes dhe Klimatizimit, | 1 |
| 30 | Jcoders | Junior Coders | 2 |
| | | Junior Full – Stack Developer | |
| Totali i kualifikimeve | | | 64 |

*Tabela 4. Aplikacionet e shqyrtuara dhe të aprovuara për vitin 2021.*



*Takim me rastin e procesit të validimit dhe akreditimit*

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat për kualifikimet e validuara/rivaliduara në KKK si dhe institucionet e akredituara/riakredituara për vitin 2021.


| Nr. | Institucionet | Qyteti | Niveli | Kualifikimi | Numri i kualifikimeve |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Universiteti Haxhi Zeka | Pejë | IV | Prodhuesit e kulturave të përziera dhe të kafshëve | 1 |
| 2 | Qendra Inovative Korabi | Çagllavicë | III | Furrtari | 2 |
| | | Çagllavicë | III | Bërës ëmbëlsirash | |
| 3 | Diakonie training center | Mitrovicë | III | Parukeri | 1 |
| 4 | QAP "Esthetic Academy Pretty Ëoman | Prishtinë | IV | Estetikë | 1 |
| 5 | Iniciative për zhvillimin e | Vushtrri | III | Prodhuesit e kulturave të përziera dhe të kafshëve | 2 |
| | bujqësisë se Kosovës(IADK) | | III | Konservues i frutave, perimeve dhe të ngjashme | |
| 6 | Qendra Sociale Edukative Don Bosko | Prishtinë | III | Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit | 3 |
| | | | III | Instalues elektrik | |
| | | | III | Instalues i ngrohjes qendrore | |
| 7 | Deutschzentrum Kosovo | Prishtinë | A1-C1 | Gjuhë gjermane | 1 |
| 8 | Deutschzentrum Kosovo | Gjilan | A1-C1 | Gjuhë gjermane | 1 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 9 | Associates for Finance and Accounting Services - "AFAS" | Prishtinë | III | Nëpunës i kontabilitetit | 1 |
| 10 | Gjon Nikollë Kazazi | Gjakovë | III-IV | Asistent administrativ | 2 |
| | | | III-IV | Bashkëpunëtor profesional i infermierisë | |
| 11 | Instituti për Kontabilitet, Auditim dhe Financa (IKAF) | Prishtinë | IV | Nëpunës kontabiliteti | 17 |
| | | | IV | Teknik i kontabilitetit | |
| | | | V | Kontabilist i Certifikuar | |
| | | | V | Auditor i certifikuar | |
| | | | V | Auditor i brendshëm në sektorin privat dhe publik | |
| | | | V | Vlerësues i bizneseve i certifikuar | |
| | | | V | Vlerësues i bizneseve i licencuar | |
| | | | V | Ekspert i licencuar i forenzikës financiare | |
| | | | V | Këshilltar tatimor | |
| | | | V | Këshilltar tatimor i licencuar | |
| | | | V | Kontrollor i certifikuar | |
| | | | V | Kontrollor i licencuar | |
| | | | V | Auditor i it i certifikuar | |
| | | | V | Menaxher i riskut i certifikuar | |
| | | | V | CFO i certifikuar | |


| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | V | Zyrtar i certifikuar ne menaxhimin e financave publike | |
| | | | V | Certifikim ne IPSAS | |
| 12 | "Kolegji ISPE" SH.P.K. | Prishtinë | IV | Bashkëpunëtor profesional i infermierisë | 2 |
| | | | IV | Teknik dentar | |
| 13 | Neë Born Master | Suharekë | III | Murator dhe punëtorët e ngjashëm | 1 |
| 14 | Shkolla e Mesme e Lartë the British School of Kosova | Prishtinë | III-IV | Bashkëpunëtor profesional i infermierisë | 2 |
| | | | III-IV | Teknik dentar | |
| 15 | Shkolla e Mesme e Lartë e Mjekësisë "VICIANA MED" | Vushtrri | III-IV | Bashkëpunëtor profesional i infermierisë | 1 |
| 16 | ATC | Prishtinë | III | Automekanik | 1 |
| 17 | UBT | Prishtinë | A1-C1 | Gjuhë angleze | 5 |
| | | | III-IV | Teknik i laboratorit mjekësor | |
| | | | III-IV | Teknik i farmacisë | |
| | | | III-IV | Bashkëpunëtor profesional i infermierisë | |
| | | | III-IV | Asistent dentar | |
| 18 | Oda Ekonomike e Kosovës | Prishtinë | IV | Instruktor në vendin e punës | 2 |
| | | | V | Vlerësues i patundshmërive | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 19 | Camellias | Prishtinë | III | Manikyrist/Manikyriste | 1 |
| 20 | Qendra e Bukurisë "Coiffure School" | Prishtinë | III | Manikyrist/Manikyriste | 3 |
| | | | III | Grim | |
| | | | III | Parukier/Parukiere | |
| 21 | Qendra e Kompetencës Skenderaj | Skenderaj | IV | Murator dhe punëtorët e ngjashëm | 1 |
| | | | | Totali i kualifikimeve | 51 |


*Tabela 5. Kualifikimet e validuara dhe institucionet e akredituara për vitin 2021.*




*Diagrami 2. Kualifikimet në KKK sipas sektorëve për vitin 2021.*




*Diagrami 3. Sektorët e kualifikimeve në KKK sipas regjioneve për vitin 2021.*




*Diagrami 4. Kualifikimet e validuara sipas niveleve për vitin 2021*

**Njohja e Mësimit Paraprak (NjMP)**

Njohja e mësimit paraprak, rregullohet me Ligjin nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare në Republikën e Kosovës. Një nga objektivat kryesore të ligjit është përmirësimi i vlerësimit të kualifikimeve, duke përfshirë përgatitjet për njohjen e mësimit paraprak.

Njohja e mësimit paraprak (NjMP), i referohet njohjes së mësimit formal, joformal dhe informal në punë apo nëpërmjet aktiviteteve të tjera, të cilat janë të pranueshme nëpërmjet procesit të identifikimit, vlerësimit dhe njohjes formale të shkathtësive të tuaja.




*Punëtori informuese për zbatimin e NjMP*

NjMP mund të zbatohet vetëm nga institucionet e akredituara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK). Korniza e qartë ligjore ekziston për akreditimin e institucioneve për zbatimin e NjMP në AAP, që përcakton mekanizmat e brendshëm dhe të jashtëm të Sigurimit të Cilësisë (SC). Për t'u akreditуar për zbatimin e NjMP, institucionet duhet ti plotësojnë kriteret specifike siç janë mekanizmat e brendshëm të sigurimit të cilësisë, pajisjet specifike, etj. Kriteret e akreditimit që duhet të përmbushen nga ofruesi që aplikon për ta zbatuar NjMP në AAP janë të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.




*Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e NjMP*

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat e institucioneve të akredituara për zbatimin e NjMP për vitin 2021.

| Nr | Ofruesi/institucioni | Qyteti | Niveli | Kualifikimi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Profesional Beauty Academy | Prishtinë | III | Parukeri |
| 2 | Qendra e Aftësimit Profesional Sauda | Pejë | IV | Parukeri |
| 3 | Qendra e Aftësimit Profesional Gjilan | Gjilan | III | Saldim |
| 4 | Qendra e Aftësimit Profesional Mitrovicë | Mitrovicë | III | Saldim |

*Tabela 6. Institucionet e akredituara për zbatimin e NjMP për vitin 2021.*

**Monitorimi i institucioneve pas akreditimit**

Zbatimi i monitorimit është i përcaktuar me Ligjin nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, sipas dinamikës së ndjekur, ka zhvilluar mekanizmat për funksionalizimin e zbatimit të procesit të monitorimit në IAAP pas akreditimit, me qëllim të monitorimit të performancës së tyre dhe konstatimit të përmbushjes së kritereve të validimit dhe akreditimit.

AKK ka zhvilluar metodologji për raportimin e numrit të mësimdhënësve dhe trajnerëve të institucioneve të akredituara si dhe të dhënat për kandidatët dhe komponentet tjera rreth certifikimit të tyre konform legjislacionit në fuqi si dhe vendimeve të KD AKK.



*Pamje nga punëtoritë dhe vizitat në procesin e akreditimit të IAAP*

Të dhënat e kandidatëve të certifikuar në IAAP e akredituara për vitin 2021

| Nr | Institucioni | Kualifikimi | Certifikimet |
|---|---|---|---|
| 1 | American Beauty School | Grim | 230 |
| | | Manikyr | 308 |
| | | Parukeri | 89 |
| 2 | Camellias | Manikyrist/Manikyriste | 33 |
| | | Grim | 14 |
| | | Parukeri | 83 |
| 3 | Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës ( SHKÇAK) | Ekspert i tatimor | 4 |
| | | Ekspert i lartë tatimor | 3 |
| | | Ekspert i licencuar i forenzikës financiare | 4 |
| | | Auditor i brendshëm i certifikuar | 37 |
| | | Auditor i certifikuar | 8 |
| | | Kontabilist i certifikuar | 18 |
| | | Teknik i Kontabilitetit | 72 |
| 4 | Coiffure School | Parukier/Parukiere | 38 |
| 5 | QAP- Prishtine | Furrtari | 40 |
| 6 | Neë Age School | Gjuhë angleze | 162 |
| 7 | i2 Defense | Trajnerët, instruktorët dhe zyrtarët sportiv | 16 |
| 8 | Kolegji Evropian I Kosovës | Shitje dhe shërbim i klientit | 14 |
| 9 | Smart Center | Gjuhë angleze | 173 |
| | | Gjuhë gjermane | 114 |
| 10 | UNI BB Sh.P.K | Modelist, prerës dhe punues të tekstilit dhe të tjerë të ngjashëm | 118 |
| | | Rrobaqepësit, rrobaqepëset gëzofpunuesit dhe kapelabërësit | 81 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 11 | Oxford Studio | Gjuhë angleze | 3411 |
| | | Gjuhë angleze | |
| 12 | Diakonie Training Center - DTC | Parukier/Parukiere | 29 |
| | | Instalues elektrik | 46 |
| | | Instalues i ngrohjes qendrore | 75 |
| | | Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit | 34 |
| 13 | Italian Beauty Cosmetics - N.Sh (IBC) | Manikyrist/Manikyriste | 473 |
| | | Pedikyrist/Pedikyriste | 423 |
| 14 | Instituti Profesional "ATC SH.P.K" | Instalues elektrik | 5 |
| | | Instalues i ujësjellësit | 4 |
| | | Menaxher i ndërmarrjeve mikro dhe te vogla | 10 |
| | | Bërës ëmbëlsirash | 20 |
| | | Ndihmës kuzhinier | 47 |
| | | Picier | 13 |
| 14 | Elektroëati Sh.P.K | Instalues elektrik | 141 |
| 15 | QAP Ferizaj | Saldim | 53 |
| | | Instalues elektrik | 22 |
| 16 | QAP Pejë | Asistent Administrativ | 25 |
| | | Instalues elektrik | 1 |
| | | Qumështar | 12 |
| 17 | QAP Prizren | Saldim | 6 |
| | | Grimer/Grimere | 30 |
| 18 | QAP Gjilan | Metalpunues | 8 |
| | | Saldim | 29 |
| 19 | QAP Mitrovicë | Metalpunues | 14 |
| | | Saldim | 59 |
| 20 | "Academy & Studio Jehona" Sh.p.k | Parukeri | 24 |
| | | Grim | 7 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 21 | Britnica ELT | Gjuhë angleze | 55 |
| 22 | ECO-Education Oxford | Gjuhë angleze | 140 |
| 23 | The Cambridge School | Gjuhë angleze | 2 |
| 24 | Iniciativa për zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës-IADK | Teknik i blegtorisë | 13 |
| | | Konservues i frutave-perimeve dhe të ngjashme | 10 |
| 25 | Professional Beauty Academy | Grimer/Grimere | 37 |
| | | Manikyrist/Manikyriste | 80 |
| | | Parukier/Parukiere | 41 |
| 26 | QAP Gjakovë | Asistent Administrativ | 17 |
| | | Instalues elektrik | 15 |
| | | Saldim | 25 |
| 27 | Aleanca Franceze | Gjuhë frënge | 73 |
| 28 | Arnisa-Z | Rrobaqepësit, rrobaqepëset, gëzofpunuesit dhe kapelabërësit | 17 |
| | | Modelist, prerës dhe punues të tekstilit dhe të tjerë të ngjashëm | 17 |
| 29 | Shkolla digjitale | Programer Junior | 90 |
| 30 | Tempulli Sh.P.K | Trafik Rrugorë | 3 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | Instruktor i shoferëve | 63 |
| 31 | English Language School | Gjuhë angleze | 14 |
| 32 | IAPP Dituria | Murator dhe punëtorët e ngjashëm | 227 |
| 33 | Infinit Qatar Traning Center | Gjuhë Angleze | 2 |
| 34 | Cacttus Education | Administrator i rrjetave dhe sistemeve kompjuterike | 3 |
| | | Zhvillues i ueb-it dhe i aplikacioneve mobile | 9 |
| 35 | Qendra e trajnimit- KEK | Instalues elektrik | 3 |
| 36 | Getting Competent | Instruktor në vendin e punës | 112 |
| 37 | PROED | Zhvillues softueri | 5 |
| 38 | UBT | Gjuhë Angleze | 103 |
| 39 | KRYOLAN KOSOVA | Grim | 484 |
| | | Parukeri | 24 |
| 40 | INTERNATIONAL BEAUTY BRANDS | Manikyr | 82 |
| 41 | STAR NAILS ACADEMY SHPK | Manikyr | 12 |
| 42 | Deutschzentrum Kosovo | Kurse të gjuhës gjermane niveli A1-C1 | 110 |
| 43 | Associates for Finance and Accounting Services - "AFAS" | Nëpunës i kontabilitetit | 62 |
| 44 | IKAF | Auditor i brendshëm në sektorin privat dhe publik | 43 |
| | | [9]Totali i të certifikuarve | 8621 |

[9] *Të dhënat e paraqitura në tabelë janë si rezultat i listave të dërguara nga IAAP dhe të verifikuara nga AKK.*

## Promovimi i KKK

AKK-ja ka zhvilluar dhe zbatuar strategji të vazhdueshme të komunikimit për të mbajtur të informuar të gjitha palët e interesit, duke përfshirë këtu edhe publikun e gjerë. Kjo është bërë nëpërmjet aktiviteteve dhe mjeteve të ndryshme, si në vijim:

- Mbajtja e takimeve të rregullta me palët e interesit (ofruesve publik, privat, institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional, si dhe partnerët zhvillimorë);
- Organizimi i punëtorive informuese për KKK-në/seminare për grupe të ndryshme të interesit;
- Organizimi i punëtorive për zhvillimin e rregulloreve dhe akteve tjera nënligjore;
- Pjesëmarrje në punëtori/seminare;
- Pjesëmarrje në media elektronike dhe të shkruara;
- Botimi dhe shpërndarja e publikimeve dhe materialeve promovuese;
- Mirëmbajtja dhe përditësimi i uebfaqes;
- Editimi dhe shpërndarja e publikimeve të ndryshme,
- Shpërndarjen e certifikatave për institucionet ofruese nga procesi i validimit dhe akreditimit;
- Popullimi i informatave në softuer, etj.




*Punëtori për promovimin e KKK*

### Takimet me palët e interesit

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, për të planifikuar, organizuar dhe zbatuar sa më mirë rregullimin e KKK, ka mbajtur takime të shumta, që kryesisht kishin të bëjnë me: informimin mbi procesin e zhvillimit dhe verifikimit të standardeve të profesionit; mbështetjen dhe udhëzimet rreth aplikimit për procesin e validimit dhe akreditimit dhe NjMP. Po ashtu, AKK ka mbajtur takime me palët e interesit lidhur me informimin për llojet e kualifikimeve, progresin, shtigjet, certifikimet, sigurimin e cilësisë si dhe benefitet e sistemit kombëtar të kualifikimeve.



*Punëtori me palët e interesit*

## Organizimi i punëtorive dhe seminareve

AKK gjatë këtij viti ka zhvilluar punëtori dhe seminare me qëllim të zhvillimit dhe zbatimit të aktiviteteve të ndryshme si dhe përfaqësuesit e AKK kanë qenë pjesëmarrës në aktivitete të ndryshme të organizuara nga palët e interesit. Punëtoritë e organizuara nga AKK lidhur me zhvillimin e dokumenteve të brendshme janë si në vijim:

- Projektrregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në AKK;
- Rregullorja për përcaktimin e procedurave për aplikimin e institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional (IAAP) për akreditim institucional, validim dhe aprovim të kualifikimeve sipas KKK dhe për aplikim të institucioneve që zbatojnë NjMP;
- Plotësim ndryshim i Rregullores së punës së KD të AKK (me mbështetjen e projektit ALLED 2);
- Plani dhe raporti I punës.



*Punëtori e organizuar nga AKK*

AKK ka qenë pjesëmarrëse edhe në aktivitete të ndryshme të organizuara nga institucione dhe partnerë zhvillimor si në vijim:

AKK në lidhje me zhvillimin e dokumenteve strategjike, ligjore dhe proceseve tjera ka zhvilluar takime të rregullta me grupe të ndryshme punuese për: Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2022-2026; Projektligjin për Arsimin e Lartë në Kosovë; Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për Akreditim; Projektligjin për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme; KAAPRr, etj.
AKK ka qenë pjesë e aktivitetit të organizuar nga MASHTI me mbështetjen e Zyrës së UNICEF- it në Kosovë për hartëzimin e kualifikimeve të sistemit arsimor të Kosovës me ISCED 11.

Ky proces mundëson krahasimin e rezultateve të arsimit dhe treguesve arsimor me të gjithë shtetet tjera dhe përshtatjen e programeve arsimore në një kategori të krahasueshme ndërkombëtarisht.AKK ka qenë aktive në një mori takimesh në raportimin tek nën-komitetit për Inovacion, shoqëri informative dhe politika sociale lidhur me zhvillimin e raportit për zbatimin e konkluzioneve nga viti i kaluar, zhvillimet legjislative, zbatimit të politikave dhe të kapaciteteve rreth zbatimit të masave të: Programit për Reforma në Ekonomi - PRE 2020-2022.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës me mbështetjen e Lux Development ka zhvilluar aktivitet për zhvillimin e bazës ligjore sekondare për ofrimin dhe rregullimin e Nivelit V të KKK. AKK ka qenë pjesë në takimet e këtij zhvillimi që nga krijimi i grupit punues e deri tek drafti final i këtij dokumentit.
AKK ka qenë pjesë e grupeve punuese për përgatitjen e kontributit (inputit) të institucioneve të Republikës së Kosovës për Raportin e KE-së për Kosovën – 2021 nga perspektiva e zhvillimeve në fushën e edukimit specifikisht në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional (AAP), sigurimin e cilësisë, kualifikimeve, etj.

AKK gjithashtu ka qenë pjesë e aktiviteteve për zhvillimin e programit të Gjuhës së Shenjave, proces ky i udhëhequr nga MASHTI për Qendrat Burimore dhe Shoqatës Kosovare e të Shurdhërve dhe i ndihmuar nga Komisioni Evropiane. AKK në këtë proces ka luajtur rolin mbështetës lidhur me informatat për mundësitë dhe kualifikimin, nevojat për përgatitjen e dokumentacionit përcjellës për procesin e aplikimit për validim dhe akreditim, etj.

## Botimi dhe shpërndarja e publikimeve dhe materialeve promovuese

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve ka qenë i angazhuar në dizajnimin, editimin, publikimin dhe shpërndarjen e një sasie të konsiderueshme të dokumenteve të nxjerra nga AKK-ja.

AKK, dokumentet kryesisht i ka publikuar në formë të shtypur dhe të njëjtat, u janë shpërndarë institucioneve të ndryshme të AAP-së dhe institucioneve tjera që ndërlidhen me fushën e AAP, si dhe palëve me interes në këtë fushë, përfshirë edhe institucionet partnere jashtë vendit.




*Material promovues rreth sigurimit të cilësisë*

**Mirëmbajtja dhe përditësimi i uebfaqes**

Uebfaqja e AKK-së përmban informata lidhur me organizimin e brendshëm, bazën ligjore, vendimet e KD, udhëzues dhe dokumente të nevojshme për implementimin e KKK, informata të ndryshme rreth proceseve të standardeve të profesionit, validimit të kualifikimeve dhe akreditimit të institucioneve, zbatim të NjMP dhe monitorim pas akreditimit, të cilat janë me interes për publikun dhe në funksion të transparencës.

Uebfaqja, gjithashtu përmban të gjitha materialet tjera të publikuara nga AKK, në mënyrë që t'ju ofrohen të gjitha palëve të interesuara, në format elektronik. Në të janë publikuar edhe lista e standardeve të profesionit që janë në proces dhe ato të aprovuara, lista me kualifikimet e aprovuara dhe institucioneve të akredituara si dhe institucionet e akredituara për zbatim të NjMP. Uebfaqja është pasuruar me linqe dhe vegëza të reja që ofrojnë mundësi më të mirë kërkimi, si dhe ndërlidhje shtesë me uebfaqet përkatëse.

Në uebfaqen e AKK janë vendosur edhe video dhe materialet tjera që janë përdorur në fushata të ndryshme mediale për të siguruar qëndrueshmëri të vazhdueshme të mesazheve të promovuara.

Për të ndihmuar vetëdijesimin e publikut të gjerë, AKK ka publikuar edhe informata të rëndësishme nëpërmjet plaftormave tjera si dhe rrjete sociale.

AKK ka marrë pjesë po ashtu edhe në numër të konsiderueshëm të tryezave të përbashkëta, në të cilat është diskutuar roli i AKK-së, funksioni dhe objektivat e KKK-së, mekanizmat e zhvilluara nga KKK-ja për zbatimin e saj, si dhe përfitimet e individit nga zbatimi I KKK-së.

**Bashkëpunimi ndërkombëtar**

AKK në vitin 2021, ka vazhduar frymën e bashkëpunimit me institucione dhe organizata të ndryshme. Në nivel vendi, AKK ka vazhduar bashkëpunimin me institucionet qeveritare, nisur nga ZKM, MASHTI, ministritë dhe agjencitë relavante, Këshillat profesionale, partnerët social, grupet e interesit, qytetarët, etj. AKK në veçanti i ka kushtuar rëndësi bashkëpunimit ndërkombëtar me institucione, organizata, rrjete, projekte si: Komisioni Evropian, Fondacioni Evropian i Trajnimeve (ETF), Grupin Këshillues të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (KEK), Agjencioni Austriak për Zhvillim (ADA), Lux Development, GiZ, Dvv International, EQAVET, ERI SEE, Alled 2, EYE, Fits for job, etj.




*Punëtori e mbështetur nga DVV International*

AKK gjatë vitit 2021, organizoi sesione trajnimesh për zbatimin e NjMP me mbështetjen nga DVV International. AKK, përmes këtij projekti kishte për qëllim mbështetjen e institucioneve të aftësimit profesional dhe të rritur, bizneset si dhe organizatat joqeveritare, konkretisht rreth informimit dhe ngritjes së kapaciteteve për komponentën e Njohjes së Mësimit Paraprak në Kosovë. Aktivitetet e projektit ishin: Identifikimi -grupet e synuara dhe përfituesit për zbatimin e NjMP, informimi për zbatimin e NjMP, sfidat, benefitet si dhe procesi i akreditimit si dhe ngritja e kapaciteteve të ofruesve dhe të AKK për NjMP.
Për të përmbushur synimin e këtij projekti, AKK realizoi:

- Trajnim informues për Zbatimin e Njohjes së Mësimit Paraprak (NjMP). Qëllimi i këtij trajnimi ka qenë informimi i institucioneve, organizatave, ofrueseve, bizneseve,etj. rreth zbatimit të Njohjes së Mësimit Paraprak (NjMP) në Kosovë, me theks të veçantë tek zhvillimi institucional, ngritja e kapaciteteve, benefitet dhe sfidat e NjMP, si dhe do të ofrohet përkrahje rreth aplikimit dhe akreditimit të tyre për të ofruar NjMP.
- Punëtori për Koordinatorët, Mentorët dhe Vlerësuesit e Njohjes së Mësimit, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve njerëzore për institucionet potenciale për zbatimin e NjMP.
- Punëtori informuese për ekspertët e jashtëm vlerësues rreth procedurave të akreditimit të institucioneve për zbatimit të Njohjes së Mësimit Paraprak (NjMP) në Kosovë.




*Pjesëmarrje e AKK në projektin ToRegos-ERI SEE*

Gjithashtu, AKK mori pjesë në projektin TO REGOS, i realizuar nga Sekretariati i Nismës së Evropës Juglindore për Reformën në Arsim-ERI SEE dhe Aleanca e Ballkanit Perëndimor, për të nxënit nëpërmjet punës në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal i Zi, në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në Serbi. Qëllimi i projektit ishte që të kontribuojë në punësimin dhe lëvizjen e të rinjve në tregun e punës në rajonin e Evropës Juglindore. Më konkretisht, projekti është përqendruar në formulimin e metodologjisë për zhvillimin e standardeve rajonale të profesionit, duke zhvilluar pesë standarde rajonale të profesionit në sektorin e turizmit dhe ndërtimit si dhe standardet përkatëse të kualifikimit në nivel kombëtar. Në kuadër të këtij projekti, AKK ka bërë verifikimin e standardeve të profesionit sipas legjislacionit në fuqi.

Projekti KSV / 801 "Përkrahja e Bashkimit Evropian (BE) për Arsim dhe Aftësim Profesional (AAP)" i financuar nga Bashkimi Evropian i cili implementohet nga Agjencia e Luksemburgut përBashkëpunim për Zhvillim-LuxDev, përpos tjerash përmban në vete komponentën e NjMP për të cilën është përfitues AKK.
Një nga qëllimet kryesore të projektit është fuqizimi i komponentës së Njohjes së mësimit paraprak (NjMP) në nivel të Kosovës dhe ta bëjë më funksional në sektorët/profesionet më të nevojshme ekonomike si një formë e rritjes së punësimit dhe mundësive të mësimit gjatë gjithë jetës.




*Pjesëmarrje e AKK në projektin ESVET PRO*

Gjatë vitit 2021, në mbështetjen e këtij projekti është zhvilluar platforma digjitale për njohjen e mësimit paraprak ku përmes kësaj platforme përveç informatave dhe dokumenteve për komponentën e NjMP do të krijohet mundësia për regjistrimin e kandidatëve në këtë platformë. Kandidatët e interesuar do të shprehin interesin e tyre për kualifikimet përkatëse, ku me këtë rast kandidatëve do t'u krijohet mundësia për të aplikuar për NjMP në institucionet e akredituara. Po ashtu, gjatë këtij viti janë zhvilluar draftdokumentet dhe udhëzuesit për ofruesit dhe ekipet vlerësuese të NjMP. Në kuadër të këtij projekti do të mbulohet edhe platforma e E-akreditimit për procesin e akreditimit për zbatimin e NjMP.

Përfaqësuesit e AKK morën pjesë në takimin e 55 të Grupit Këshillues i Kornizës Evropiane të Kualifikimeve. Në këtë takim u diskutua dhe u pasqyruan raporte mbi zhvillimet kombëtare rreth KEK, po ashtu u paraqit raporti i grupit të projektit "Krahasimi Horizontal", përditësimet dhe prezantimi i rezultateve të anketës së KKK nga Cedefop. Në këtë takim u paraqiten edhe raportet e përditësuara të referencimit nga shtetet: Franca dhe Italia.

Ne ditën e dytë u diskutuan dhe u paraqiten përditësime mbi validimin e të mësuarit joformal dhe joformal si mekanizmat për zhvillimin e metodologjive cilësore të validimit.




*Pjesëmarrja e AKK në takimin e Grupit Këshillues të KEK*

Përfaqësuesit e AKK morën pjesë në takimin e 56 të Grupit Këshillues i Kornizës Evropiane të Kualifikimeve. Në këtë takim u diskutua dhe u raportua mbi zhvillimet kombëtare në zbatimin e KEK, u prezentuan rezultatet për lidhjen e aftësive deri në kualifikim nga platforma ESCO. Po ashtu, në pjesën tjetër takimi u fokusua tek përditësimet mbi vlefshmërinë/validimin e të mësuarit joformal dhe joformal si dhe raportin mbi "Eksplorimi i rrugëve plotësuese për në "certifikimin" në fushën e NjMP.

AKK është pjesë e Bordit Këshillues të projektit Alled II dhe gjatë këtij viti janë mbajtur disa takime. Në këto takime u paraqitën aktivitetet në raport me komponentet e projektit si dhe u diskutuan çështjet te cilat janë realizuar si edhe ato të cilat janë në proces apo në plan të zhvillimit. AKK me mbështetjen e këtij projekti ka plan zhvillimin e mekanizmave për monitorim pas akreditimit, nivelin V të KKK, NjMP, regjistrin e kualifikimeve, sigurimin e cilësisë, etj.

AKK, po ashtu ka qenë aktive në takimet rreth Barometrit Kosovar të Aftësive të organizuar nga projekti Alled II. Kjo platformë shërben për t'u shërbyer nevojave të punëdhënësve dhe politikbërësve duke mbështetur Odën Ekonomike të Kosovës – OEK për zhvillimin sistematik të Vlerësimit të Nevojave për Trajnim/Barometri i Shkathtësive, si një mjet për planifikimin e AAP dhe për zbulim të strukturuar dhe sistematik të aftësive/kompetencave të ardhshme të nevojshme në tregun e punës.




*Pjesëmarrje e AKK në takimin me ETF*

Me ftesë të Fondacionit evropian për trajnime, AKK si çdo vit, mori pjesë në aktivitete të ndryshme të planifikuara nga forumi për sigurimin e cilësisë për arsim dhe aftësim profesional. Disa nga këto aktivitete ishin:

- Forumi i ETF për sigurimin e cilësisë në AAP;
- Mekanizmat në sistemin e AAP-së dhe nivelin e ofruesve për të vlerësuar performancën e mësuesve dhe trajnerëve;

- Sigurimi i cilësisë për mësimin e bazuar në punë;
- Lidhja e kualifikimeve në vendet partnere dhe më gjerë duke përdorur Kornizën Evropiane të Kualifikimeve dhe përvojën e shtetit të Ukrainës;
- Sigurimi i cilësisë në aftësimin profesional të vazhdueshëm.

Përfaqësuesit e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve morën pjesë edhe në takimin virtual të organizuar nga Fondacioni Evropian i Trajnimeve (ETF) me temën "Ndërlidhja e databazës së kualifikimeve të shteteve partnere duke përdorur Kornizën Evropiane të Kualifikimeve- KEK". Në këtë takim u shpalos mundësia e ndërlidhjes së kualifikimeve nëpërmjet databazave shtetërore dhe ndërlidhja me platformën e KEK si "Regjistri i të dhënave të Kualifikimeve", pastaj ndërlidhja me Europass, ESCO, etj.



*Pjesëmarrje e AKK në takime me ALLED 2*

AKK ka qenë pjesëmarrës dhe ka kontribuar në seancat e trajnimeve, të organizuara nga projektit ALLED 2, ku temat që u shtjelluan ishin të ndara në këto module:

- Rishikimi i proceseve aktuale për sigurimin e cilësisë në AAP, në nivel të ofruesve dhe në nivel vendi;
- Zhvillimi i kapaciteteve të shkollave të AAP-së për të përmirësuar proceset e sigurimit të cilësisë;
- Zhvillimi i kapaciteteve të shkollave të AAP-së për planifikimin e kurrikulës;
- Zhvillimi i kapaciteteve të qendrave për aftësim profesional (duke përfshirë dy qendrat e aftësimit profesional në qendrat e shërbimit korrektues) për të përmirësuar proceset e sigurimit të cilësisë.

Gjithashtu, AKK kontribuoi në raportet dhe hulumtimet e prezentuara nga ky projekt me temat:

- Përsosmëria në AAP me fokus të veçantë të procesit të validimit dhe akreditimit;
- Procesi i monitorimit për ofruesit e AAP pas akreditimit në Kosovë dhe hapat e mëtutjeshëm.



*Pjesëmarrja e AKK në projektin ALLED 2*

Për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë në AAP, projekti i GIZ-it "Fit for Jobs" ka filluar nga ky vit të jep mbështetje teknike AKK-së në rishikimin e Kornizës Kombëtare të Sigurimit të Cilësisë (KKKK), duke reflektuar të gjitha aspektet e rëndësishme në fushën e SC. në AAP. Komponentët tjera në këtë mbështetje vënë theksin tek zhvillimi i metodologjive dhe udhëzuesve të rinj rreth zbatimit të mësimit në vendin e punës dhe mësimit online nga perspektiva e sigurimit të cilësisë, platforma për verifikimin dhe zhvillimin e standardeve të profesionit, etj.

AKK mori pjesë në organizimin nga Komisioni Evropian dhe Cedefop për qëllim të përditësimit të Udhëzimeve Evropiane ekzistuese për validimin e të mësuarit joformal dhe informal (VMJI). Ky event ishte dy ditor dhe u mbajt nëpërmjet platformës online. Kjo ngjarje mblodhi mbi 120 palë të interesuara nga sektorë dhe kontekste të ndryshme. Pjesëmarrësit luanin rol aktiv në diskutime lidhur me çështjet që ndërlidhen me validimin e të mësuarit joformal dhe joformal duke pasqyruar nevojat dhe sfidat rreth VMJI nga politikat deri në zbatim.

Përfaqësuesit e AKK morën pjesë në takimin e 57 të Grupit Këshillues i Kornizës Evropianë të Kualifikimeve. Në këtë takim u diskutua mbi zhvillimet kombëtare në nivel të zbatimit të KEK nga Komisioni Evropian, po ashtu u paraqiten informata rreth: Procesit të vlerësimit të KEK, grupi i projektit paraqiti përshkrime të shkurtra për zhvillimet në vendet të treta si dhe mbi temën: "Mikrokredencialet". Pikë tjetër e rëndësishme në këtë takim ishin edhe paraqitja e raportit të përditësuar të referencimit nga shteti i Belgjikës si dhe raporti i referencimit nga Shqipëria.

Ne ditën e dytë u diskutuan dhe u paraqiten përditësime mbi validimin e të mësuarit joformal dhe joformal si dhe u pasqyrua progresit i bërë në eventin e validimit me fokus përditësimin e Udhëzimit Evropian për validim.

Adresa: Qendra Studentore
Rr. "Agim Ramadani" p.n.
10 000 Prishtinë
Republika e Kosovës

